

4You magazine

www.magazineforyou.com



4You Magazine - Shqip

magazine4ushqip



Revistë mujore e KFOR-it Nr. 200 - Tetor 2023



MUSICBOX
**MITROVICA
INTERNATIONAL
JAZZ FESTIVAL**



Falas

"4You Magazine" është publikim zyrtar i KFOR-it, prodhuar dhe financiar nga KFOR-i, i shtypur në Kosovë dhe shpërndahet pa pagesë. Përbajtja nuk reflekton qëndrimin zyrtar të koalicionit apo të shteteve anëtare. KFOR-i pranon edhe i mirëpret opinionet tuaja dhe i publikon ato, por në formë të përmbledhur. Nëse kërkohet emri i autorit të mos tregohet, kjo mund të bëhet, por nuk do të publikohen letra anonime, shpifëse apo me qëllim të keq.

Kryeredaktore:

Leonora Shabanaj Nikshiq

Gazetarë: Ali Rexha,

Violeta Matovic,

Jelena Simic Rasic

Fotografitë: Ekipi "4You"

Design & Layout:

Bekim Shabani &

Leopard Cana

Stafi editorial mund të kontaktohet në telefon:

038/503-603-2139

Letrat mund të dërgohen në adresën:

HQ KFOR - Kosova Film;

"4You Magazine";

Strasbourg Building;

10000 Prishtinë

E-mail:

magazineforyou2003@gmail.com

www.magazineforyou.com



Kopertina:

JAZZ FESTIVAL

Editorial

Të dashur lexues,

Më duhet ta nis këtë editorial duke e vënë në pah entuziazmin tim në përgatitjen e këtij numri të revistës sonë. Ky numër e shënon një tjetër moment historik të jashtëzakonshëm në rrugëtimin tonë dhe më sjell kënaqësi të madhe ta ndaj me ju, ndërsa ne e vazhdojmë me krenari traditën tonë të botimit në pesë gjuhë të ndryshme. Ky angazhim i qëndrueshëm e nënvizon përkushtimin tonë për t'u siguruar që çdo adoleshent/e, pavarësisht nga formimi i tyre gjuhësor, të ndihet i/e pranuar, i/e dëgjuar dhe i/e përfaqësuar plotësisht brenda faqeve të revistës sonë.

Rëndësia e diversitetit në redaksi

Diversiteti është një pasuri e çmuar që e pasuron jetën tonë, i zgjeron horizontet tona dhe i formëson perspektivat tona. Bota jonë është një sixhade e ndërlikuar e thurur nga një mori gjuhësh, kulturash dhe traditash. Përqafimi dhe festimi i këtij diversiteti nuk është thjesht një zgjedhje, por një domosdoshmëri. Duke e ofruar edhe një herë revistën tonë në shumë gjuhë, ne e riafirmojmë misionin tonë kryesor: thyerjen e barrierave gjuhësore dhe ftuarjen e adoleshentëve të të gjitha prejardhjeve për t'u bërë pjesë e komunitetit tonë të gjallë.

Gjithëpërfshirja në veprim

Tani, ju mund ta pyesni veten pse kjo nismë e vazhdueshme e ka një rëndësi të tillë. Para së gjithash, ajo sillet rreth gjithëpërfshirjes. Ne jemi të përkushtuar që të sigurohemi që çdo adoleshent, pavarësisht nëse ka qenë me ne që nga fillimi ose sapo e ka zbuluar revistën tonë, të ketë një ndjenjë të thellë të pronësisë. Ne besojmë fuqishëm se gjuha nuk duhet të shërbejë kurrë si një barrierë që e pengon qasjen në informacion, argëtim dhe frymëzim.

Frymëzimi i një lëvizjeje më të gjerë

Gjithëpërfshirja dhe diversiteti mbesin në qendër të misionit tonë. Nëpërmjet angazhimit tonë të palëkundur për të botuar revistën tonë në shumë gjuhë, ne aspirojmë të frymëzojmë edhe shtëpitë e tjera botuese që të ndjekin shembullin tonë dhe ta bëjnë përbajtjen e tyre të qasshme për të gjithë. Me kënaqësi i ftojme lexuesit e rinj dhe ata që na kanë përkrahur nga fillimi t'na bashkohen në këtë udhëtim magjepsës.

Ftesë për një odise shumëgjuhëshe

Në numrin tonë të ardhshëm përgatitimi për një tjetër përvojë gjithëpërfshirëse, shumëgjuhëshe. Pavarësisht se a e keni gjuhë amtare njërën prej gjuhëve të paraqitura ose thjesht jeni kurrestarë të zbuloni botë të reja përmes fjalëve, ju premtojmë se ky numër do të jetë një festë tjetër e gjallë e gjuhës, kulturës dhe unitetit.

Të festojmë gjërat e përbashkëta përmes dallimeve

Në një botë të fiksuar shpesh te dallimet, ne e mbështesim me vendosmëri krenatimin e asaj që na bashkon: njerëzishmërinë tonë të përbashkët dhe aftësinë e thellë të fjalëve për t'i kapërcyer edhe ndarjet më të mëdha të mudshme. Së bashku, ne këmbëngulim në krijimin e një të ardhmeje më të ndritshme, më gjithëpërfshirëse, ku çdo zë jo vetëm që dëgjohej, por festohej.

Faleminderit, si gjithmonë, që jeni pjesë e paçmueshme e komunitetit tonë të larmishëm dhe dinamik. Qëndroni me ne për numrin tonë të ardhshëm, ku gjuha vazhdon të jetë çelësi për të zhbllokuar një botë me mundësi të pakufishme.

**Deri në takimin tonë të radhës,
mirëmbetshi miqtë e mi!**

Leonora

Indeksi



2. Editoriali, indeksi

4. Shkolla e muajit: SHFMU "BAJRAM CURRI" NË KRUSHË TË MADHE

6. 'MostUra' BASHKON RININË E KOSOVËS

8. Life Style: NGJYRAT E VJESHTËS 2023

10. Music Box: NOTA HARMONIKE:

FESTIVALI INAUGURUES I DITËVE

NDËRKOMBËTARE TË XHAZIT MITROVICË

12. LOJËRAT PARASPORTIVE KOSOVË 2023:

KRIJIMI I LIDHJEVE, FUQIZIMI I UNITETIT!

14. World around Us: RRUGËT MË ATRAKTIVE NË BOTË

16. Do it Yourself: SHPORTAT QË MUND T'I BËNI VETË

18. Moviemania: FESTIVALI I FILMIT TRIBECA: NDERIMI I INOVACIONIT, TREGIMIT DHE ARRITJEVE KREATIVE"

20. Health & Sports: SË BASHKU DREJT MAJËS - ENISA DHE MELISA -- FORCA E DYFISHT E PINGPONG-ut

24. "UNIFIKIMI I ZEMRAVE DHE AFTËSIVE: KAMPI NDËRETNIK I TENISIT NË KOSOVË"

26. Your opinion about: MENDIMI JUAJ PËR ËMBËLSIRAT (DESERTET)?

28. Wellbeing & teens: REALITET KUNDREJT MEDIAVE SOCIALE!

30. Brainteasers: KËNDI ENIGMATIK

32. Did you know? VJESHTA

Editorial

Dear readers,

I must commence this editorial by emphasizing, once more, my enthusiasm in preparing this issue of our magazine. This marks yet another remarkable milestone in our journey, and it brings me great pleasure to share it with you, as we proudly continue our tradition of publishing in five different languages. This enduring commitment underscores our dedication to ensuring that every teenager, regardless of their linguistic background, feels recognized, heard, and fully represented within the pages of our magazine.

The Significance of Diversity in Print

Diversity is a precious asset that enriches our lives, broadens our horizons, and shapes our perspectives. Our world is an intricate tapestry woven from a multitude of languages, cultures, and traditions. Embracing and celebrating this diversity is not just a choice but a necessity. By once again offering our magazine in multiple languages, we reaffirm our core mission: breaking down linguistic barriers and extending an open invitation to teenagers from all backgrounds to become part of our vibrant community.

Inclusivity in Action

Now, you may wonder why this ongoing initiative holds such significance. First and foremost, it revolves around inclusivity. We are committed to ensuring that every teenager, whether they have been with us from the very beginning or are just discovering our magazine, feels a profound sense of ownership. We firmly believe that language should never serve as a barrier hindering access to information, entertainment, and inspiration.

Inspiring a Wider Movement

Inclusivity and diversity remain at the very heart of our mission. Through our unwavering commitment to publishing our magazine in multiple languages, we aspire to inspire other publications to follow suit and make their content accessible to everyone. We warmly invite both young and seasoned readers to join us on this captivating journey.

An Invitation to a Multilingual Odyssey

Prepare yourselves for yet another immersive, multilingual experience in our upcoming issue. Whether you are a native speaker of one of the featured languages or simply curious about exploring new worlds through words, we promise that this edition will stand as another vibrant celebration of language, culture, and unity.

Celebrating Commonality Amidst Differences

In a world often fixated on differences, we steadfastly uphold the celebration of what unites us: our shared humanity and the profound ability of words to bridge even the widest divides. Together, we persist in creating a brighter, more inclusive future where every voice is not only heard but celebrated.

Thank you, as always, for being an invaluable part of our diverse and dynamic community. Stay tuned for our next issue, where language continues to be the key unlocking a world of boundless possibilities.

Until our next meeting,
stay healthy my friends!

Leonora

Index



3. Editorial, index

5. **School of the month:** EJHS BAJRAM CURRI IN KRUSHE E MADHE

7. 'MostUra' FESTIVAL UNITES KOSOVO'S YOUTH

9. **Life Style:** AUTUMN COLORS 2023

11. **Music Box:** HARMONIOUS NOTES: THE INAUGURAL MITROVICA INTERNATIONAL JAZZ FESTIVAL

13. PARASPORT GAMES KOSOVO 2023:

FORGING BONDS, EMPOWERING UNITY!

15. **World around Us:** THE MOST ATTRACTIVE ROADS ACROSS THE WORLD

17. **Do it Yourself:** DO-IT-YOURSELF FRUIT BASKET

19. **Moviemania:** TRIBECA FILM FESTIVAL: HONORING INNOVATION, STORYTELLING, AND CREATIVE ACHIEVEMENT

21. **Health & Sports:** TOGETHER TO THE TOP - ENISA AND MELISA - THE DOUBLE POWER OF TABLE TENNIS

25. "UNIFYING HEARTS AND SKILLS: INTERETHNIC TENNIS CAMP IN KOSOVO"

27. **Your opinion about:** YOUR OPINION ON DESSERTS?

29. **Wellbeing & teens:** REALITY VS SOCIAL MEDIA!

31. LET'S LEARN TOGETHER

32. **Did you know?** AUTUMN

4You

magazine

"4You Magazine" is an official publication of KFOR, produced and financed by KFOR, printed in Kosovo and distributed freely. The contents do not necessarily reflect the official point of view of the coalition or that of any of its member states. KFOR accepts and welcomes your opinions, it will publish some of these, eventually in a condensed form. If requested the name of the writer will be withheld but no anonymous, defamatory or malicious letters will be printed.

Chief Editor:

Leonora Shabanaj Nikshiq

Journalists:

Ali Rexha,
Violeta Matovic,

Jelena Simic Rasic

Photos by:

"4You" Team
Bekim Shabani &
Leopard Cana

The editorial staff can be contacted on:

038/503-603-2139

Any letters can be sent at:

HQ KFOR - Film City;
"4You Magazine";

Strasbourg Building;
10000 Pristina

E-mail:

magazineforyou2003@gmail.com
www.magazineforyou.com



Cover:

JAZZ FESTIVAL

SHFMU 'BAJRAM CURRI' NË KRUSHË TË MADHE

Shkolla fillore dhe e mesme e ulët "Bajram Curri", një gurthemel i arsimit në Krushë të Madhe, e ka një të kaluar të begatshme që daton që nga fillimi i saj në vitin 1926. Viti historik i themelimit të shkollës është skalitur në muret e godinës së saj origjinale, duke shërbyer si një dëshmi për trashëgiminë e saj të qëndrueshme. Gjatë viteve të saj të para, këtu mbledheshin nxënës nga fshatrat fqinje si Nagaci, Celina, Krusha e Vogël, Qëndresa (ish Randobravë), Pirana, Hoça e Vogël dhe Brestovci. Me kalimin e kohës, këto shkolla paralele përfundimisht u ndanë dhe u bënë të pavarura.



bollshme për arsim cilësor, të realizuar në një ndërrim të vetëm.

Me fokus efikasitetin, shkolla aktualisht funksionon pa klasa paralele, duke siguruar që të gjithë 505 nxënësit të marrin një arsim cilësor brenda një ndërrimi të vetëm. Stafi i përkushtuar e përfshin drejtorin, sekretarin, pedagogun, ndihmësin për edukim special, koordinatorin e cilësisë, mësuesin mbështetës, 32 mësime dhe katër anëtarë të personelit teknik. Kabinetet e pajisura mirë për biologji, kimi, fizikë dhe shkencë kompjuterike, së bashku me një studio arti, e pasurojnë përvojën e të nxënët.

Fuqizimi i mendjeve, pasurimi i jetëve

SHFMU "Bajram Curri" ka shkëlqyer vazhdimisht në aspektin akademik, duke arritur renditje të larta si në nivelin lokal ashtu edhe në nivelin kombëtar. Nxënësit i kanë

shfaqur talentet dhe përkushtimin e tyre duke siguruar fitore në gara të ndryshme të diturisë. Për më tepër, performanca e tyre e jashtëzakonshme në Testin e Arritshmërisë e nënvizon përkushtimin e tyre për të mësuar.

Sipas drejtorit, z. Rezart Veseli, prapa sukseseve të tyre janë disa arsye: "Unë do të thosha se gurthemeli i të gjitha suksesve tona është bashkëpunimi i madh që e kemi me prindërit. Këshillat e Prindërve kanë qenë të rëndësishëm në nxitjen e lidhjeve të forta ndërmjet nxënësve, shkollës dhe prindërve. Megjithatë, asgjë nuk do të ishte e mundur pa përkushtimin dhe punën e palodhshme nga mësuesit tanë, të cilët nga ana e tyre i motivojnë nxënësit që të japin më të mirën e tyre dhe të synojnë për përsosmëri."

Z. Veseli vazhdoi duke shpjeguar se kualiti



Z. Rezart Veseli - drejtor

Shkolla e mban me krenari emrin e Bajram Currit, heroit malësor, lindja e të cilit në Krushë të Madhe ishte një kthesë e fatit. I lindur nga një nënë atdhetare rrugës për në Shkup, ai u gjend në këtë fshat, ku gratë vendase ndihmuan në lindjen e tij. Kështu, Bajram Curri u bë pjesë e familjes Tahiri, e cila në përputhje me traditën ia vuri atij emrin.

Objekte të reja, mundësi të reja

Në maj të vitit 2023, Shkolla Bajram Curri bëri një hap të rëndësishëm duke u zhvendosur në ambientet e saj bashkëkohore, me 30 klasa të mëdha që e nisin një epokë të re të arsimit. Me një sipërfaqe prej 4800 metrash katrorë, ambientet moderne të shkollës ofrojnë hapësirë të





fikimet e stafit mësimdhënës janë shembullore, me të gjithë edukatorët të mirëtrajnuar dhe të kualifikuar për zbatimin efektiv të kurrikulës së re. Në fakt, ai theksoi më tej se pasuria më e fortë e shkollës qëndron në qasjen e saj të mësimdhënies së bazuar në kompetenca, që mbështetet nga përkushtimi i palëkundur i të gjithë stafit arsimor.

Nga fillimi modest në modernitet

Teksa Shkolla "Bajram Curri" ka arritur sukses të madh, ajo përballet edhe me sfida. Një shqetësim urgjent është mungesa e një salle të dedikuar për edukatë fizike, gjë që i pengon aspektet praktike të edukimit fizik dhe aktiviteteve sportive. Ndërsa, sa i përket projekteve të ardhshme, shkolla është e përkushtuar që të rrisë cilësinë e arsimit përmes digjitalizimit, ndërtimit të klasave verore, krijimit të këndit të leximit, shfaqjes së kulturës dhe vlerave kombëtare, si dhe hapjes së një radiostacioni shkollor për të festuar arritjet e nxënësve në arsim.



Arsimi është çelësi për të realizuar ëndrrat tuaja
SHFMU "Bajram Curri" qëndron si një fener i përsosmërisë arsimore, duke ndërthurr historinë e saj të pasur me një qasje moderne ndaj të nxënësve. Me stafin e saj të përkushtuar, përkushtimin ndaj inovacionit dhe fokusimin në kultivimin e kompetencave, ky institucion vazhdon të formësojë mendjet e ndritura të së ardhmes së Kosovës. Në këtë frymë, në një mesazh të përzemërt për të rinjtë kosovarë, z. Veseli e theksoi fuqinë transformuese të arsimit, duke i nxitur ata që të ndjekin dijen dhe përsosmërinë. Arsimit, pohon ai, është çelësi për të realizuar ëndrrat dhe ambiciet tuaja.

EJHS "BAJRAM CURRI" IN KRUSHE E MADHE

The Elementary and Junior High School "Bajram Curri", a cornerstone of education in Krusha e Madhe, has a storied past that dates back to its inception in 1926. The historic year of the school's founding is etched into the walls of its original building, serving as a testament to its enduring legacy. In its early years, students from neighboring villages such as Nagaci, Celina, Krusha e Vogël, Qëndresa (formerly Randobravë), Pirana, Hoça e Vogël, and Brestovc gathered here for their education. As time passed, these parallel schools eventually separated and became independent.

The school proudly bears the name of Bajram Curri, a mountain hero whose birth in Krusha e Madhe was a twist of fate. Born to a patriot mother en route to Skopje, he found himself in this village, where local women assisted in his delivery. Thus, Bajram Curri became a part of the Tahiri family, which in keeping with the tradition gave him his name.

New Facilities, Fresh Opportunities

In May 2023, Bajram Curri School took a significant stride by relocating to its contemporary premises, boasting 30 spacious classrooms that usher in a new era of education. Covering an area of 4800 square meters, the school's modern facility provides ample room for quality education, conducted in a single shift.

With a focus on efficiency, the school currently operates without parallel classes, ensuring that all 505 students receive a high-quality education within a single shift. The dedicated staff includes a director, secretary, pedagogue, special education assistant, quality coordinator, support teacher, 32 teachers, and four technical staff members. The well-equipped laboratories for biology, chemistry, physics, and computer science, along with an art studio, enrich the learning experience.

Empowering Minds, Enriching Lives

EJHS Bajram Curri has consistently excelled academically, achieving top rankings both locally and nationally. The students have showcased their talents and dedication by securing victories in various knowledge competitions. Additionally, their remarkable performance in the National Achievement Test underscores their commitment to learning. According to the principal, Mr. Rrezart Veseli there are several reasons to their successes: "I would say that the main cornerstone to all our successes is the great cooperation we have with parents. Parent Councils have been instrumental in fostering strong connections between students, the school, and parents.

However, nothing would be possible without the dedication and hard work from our teachers who in turn motivate our students to give their best and strive for excellence."

Mr. Veseli went on explaining that the teaching staff's qualifications are exemplary, with all educators well-trained and qualified to effectively implement the new curriculum. In fact he went on stressing that the school's strongest asset lies in its competency-based teaching approach, upheld by the unwavering dedication of the entire educational staff.

From Humble Beginnings to Modernity

While Bajram Curri School has achieved great success, it also faces challenges. A pressing concern is the absence of a dedicated physical education room, which impedes practical aspects of physical education and sports activities. Whereas, in terms of future projects, the school is committed to enhancing the quality of education through digitalization, constructing summer classrooms, establishing a reading corner, showcasing national culture and values, and launching a school radio station to celebrate students' educational achievements.

Education is the Key to Unlock Your Dreams

EJHS Bajram Curri stands as a beacon of educational excellence, blending its rich history with a modern approach to learning. With its dedicated staff, commitment to innovation, and focus on nurturing competencies, this institution continues to mold the bright minds of Kosovo's future. In this spirit, in a heartfelt message to Kosovo's youth, Mr. Veseli emphasized the transformative power of education, urging them to pursue knowledge and excellence. Education, he affirms, is the key to unlocking your dreams and ambitions.

FESTIVALI 'MostUra' E BASHKON RININË E KOSOVËS



Për tre ditë qyteti i bukur historik i Prizrenit ishte nikoqir i edicionit të parë të Festivalit 'MostUra'. Kjo festë unike tre-ditore mblodhi së bashku të rinj me prejardhje të ndryshme etnike, duke e fuqizuar unitetin dhe duke krijuar lidhje.

Lindja e festivalit 'MostUra'

Festivali 'MostUra', një ide e Ilda Kramës, arkitekte e re nga Mitrovica, mban një emër që e mishëron thelbin e tij. Me prejardhje nga fjalët serbe dhe boshnjake "Most" që do të thotë 'Urë' dhe fjala shqipe "Ura", festivali e simbolizon unitetin mes rinisë së Kosovës. Ideja zuri rrënjë pasi Ilda dhe kolegët e saj morën pjesë në Asambleenë Rinore të Qershorit 2023 në Prizren, ku lidhjet e tyre të miqësisë evoluan në një projekt që e siguroi grantin financiar për realizim.

Sipas Ildës, festivali doli të ishte shumë më tepër nga sa shpresonin apo prisnin ajo dhe bashkëthemeluesit e tjerë. "Ky festival shkoi përtej diskutimeve kulturore, traditave dhe lidhjeve familjare. Të pranishmit e filluan një turne kulturor, duke vizituar vendet ikonike në Prizren, Gjakovë dhe Deçan, përfshirë ndërtesën historike të Lidhjes Shqiptare dhe Manastirin frymëzues të Deçanit. Dita përmbyllëse shfaqti shprehje kreative të paqes përmes pikturës, ekspozitave të objekteve kulturore dhe shfaqjeve multikulturore nga një grup i larmishëm," theksoi Ilda.

Një sixhade e diversitetit

Edicioni inaugurues i 'MostUra' zgjati tri ditë të mrekullueshme, duke tërhequr të rinj me prejardhje të ndryshme etnike që jetojnë në Kosovë, duke i përfshirë shqiptarët, serbët, boshnjakët, turqit dhe romët. Gjatë bisedës sonë, Ilda theksoi se ishte thellësisht emocionuese për të që të shihje se si të rinjtë me prejardhje të ndryshme bashkoheshin, krijojnë mirëkuptim dhe bashkëpunonin.

Riga Sadiku, studente dhe pjesëmarrëse e këtij festivali i konfirmoi ndjenjat e Ildës. "Përmes bashkëpunimit, miqësisë dhe



eksplorimit të monumenteve, Festivali 'MostUra' e shfaqti potencialin për unitet në Kosovë. Unë u preka thellësisht nga aftësia e 'MostUra' për të bashkuar të rinj me prejardhje të ndryshme," tha Riga. Ajo vazhdoi duke u kërkuar të rinjve të Kosovës që të jenë mendje hapur dhe të punojnë drejt një Kosove paqësore.

Themeluesit nga botë të ndryshme:

Një ekip multikulturor

Themeluesit e 'MostUra', përfshirë Ilda Krama (nga Mitrovica), Blel Halili (nga Prishtina), Shenoll Çulanxhi (nga Prizreni) dhe Eris Hasani (nga Peja), e përfaqësojnë një mikrokozmos të multikulturalizmit. Pavarësisht mungesës së përvojës në organizimin e ngjar-

jeve të tilla, ekipi i tyre multikulturor e realizoi me sukses një festival të paharrueshëm. Ilda e theksoi kurbën e pjerrët të të mësuarit, veçanërisht në lidhje me logjistikën, por vuri në dukje se përvoja e pasuroi të kuptuarit e tyre për organizimin e aktivitetëve.

“Ndikimi i festivalit rezonon thellë tek ne si themelues, por edhe tek pjesëmarrësit. Për mua, mësimet e nxjerra shtrihen përtej logjistikës dhe planifikimit të ngjarjeve. Më e rëndësishmja, ‘MostUra’ e demonstroi potencialin e të rinjve të Kosovës për të ndërtuar një shoqëri paqësore, duke theksuar dëshirën për të kuptuar dhe bashkëpunuar në vija etnike dhe kulturore si rrugën drejt një të ardhmeje harmonike”, tha Ilda. Në lidhje me këtë, Sanja Radosavljevic, një 18-vjeçare e diplomuar nga Shkolla e Mesme e Mjekësisë, e çmoi kohën e saj në ‘MostUra’. Ajo e vlerësoi më së shumti mundësinë për të takuar bashkëmohatarë me prejardhje të ndryshme, për të eksploruar vende të reja dhe për të vlerësuar trashëgiminë e pasur kulturore të Kosovës.

Shenoll Çulanxhi, një tjetër bashkëthemelues i ‘MostUra’, e theksoi rolin e festivalit në thyerjen e stereotipeve dhe paragjykimëve: “Duke e nxitur bashkëpunimin, miqësinë dhe shkëmbimin kulturor, ngjarjet si ‘MostUra’ i shtrojnë bazat për brezat e ardhshëm që të komunikojnë dhe bashkëpunojnë në mënyrë më efektive, që përfundimisht e formëson një Kosovë më të mirë”.

Një Kosovë më e ndritshme, më gjithëpërfshirëse

Si përfundim, Festivali ‘MostUra’ qëndron si një dëshmi e fuqishme e potencialit për unitet dhe mirëkuptim mes të rinjve kosovarë. Ai tregoi se duke hequr dorë nga paragjykimet dhe duke e përqaftuar diversitetin, të rinjtë mund ta ndërtojnë një të ardhme më të ndritshme dhe më harmonike për veten dhe brezat që do të vijnë. Edicioni inaugurues i ‘MostUra’ ka lënë gjurmë të pashlyeshme, duke e ndriçuar rrugën drejt një Kosove më gjithëpërfshirëse dhe paqësore.



‘MostUra’ FESTIVAL UNITES KOSOVO'S YOUTH

For three days the beautiful historic city of Prizren hosted the first edition of the MostUra Festival. This unique three-day celebration brought together young people from diverse ethnic backgrounds, empowering unity, and fostering connections.

The Beginning of MostUra Festival

The MostUra Festival, a brainchild of Ilda Krama, a young architect from Mitrovica, carries a name that embodies its essence. Derived from the Serbian and Bosnian words "Most" and the Albanian word "Ura," both meaning "Bridge," the festival symbolizes unity among Kosovo's youth. The idea took root after Ilda and her colleagues participated in the June 2023 Youth Assembly in Prizren, where their bonds of friendship evolved into a project securing grant funding for implementation.

According to Ilda, the festival turned out to be much more than what she and the other cofounders hoped or expected. “This festival transcended cultural discussions, traditions, and familial bonds. Attendees embarked on a cultural tour, visiting iconic sites in Prizren, Gjakova/Djakovica, and Deçan/Decane, including the historic Albanian League building and the awe-inspiring Deçan/Decane Monastery. The concluding day featured creative expressions of peace through painting, cultural object showcases, and multicultural performances by a diverse band,” Ilda stressed.

A Tapestry of Diversity

MostUra's inaugural edition spanned three remarkable days, attracting young people from diverse ethnic backgrounds living in Kosovo, including Albanians, Serbs, Bosnians, Turks, and Roma. During our conversation Ilda highlighted that it was profoundly emotional for her to witness youth from different backgrounds come together, forge understanding, and collaborate.

Riga Sadiku, a student, and participant of this festival confirmed Ilda's sentiments. "Through cooperation, friendship, and exploration of monuments, the MostUra Festival showcased the potential for unity in Kosovo. I was profoundly moved by MostUra's ability to bring together young people of diverse backgrounds," Riga stated. She went on urging Kosovo's youth to be open-minded and work toward a peaceful Kosovo.

Founders from Different Worlds: A Multicultural Team

MostUra's founders, including Ilda Krama (from Mitrovica), Blerina Halili (from Prishtinë/Pristina), Shenoll Çulanxhi (from Prizren), and Eris Hasani (from Peja), represent a microcosm of multiculturalism. Despite their lack of experience in organizing such events, their multicultural team successfully executed a memorable festival. Ilda emphasized the steep learning curve, especially concerning logistics, but noted that the experience enriched their understanding of event organization.

“The festival's impact resonates deeply with us as founders but the participants as well. For me, the lessons learned extend beyond logistics and event planning. Most importantly, MostUra demonstrated the potential for Kosovo's youth to build a peaceful society, emphasizing the desire to understand and cooperate across ethnic and cultural lines as the path to a harmonious future,” Ilda stated. In relation to this, Sanja Radosavljevic, an 18-year-old graduate from the Medical High School, cherished her time at the MostUra. She appreciated the most the opportunity to meet peers from various backgrounds, explore new places, and appreciate Kosovo's rich cultural heritage.

Shenoll Çulanxhi, another cofounder of MostUra, emphasized the festival's role in dismantling stereotypes and prejudices: "By fostering cooperation, friendship, and cultural exchange, events like MostUra lay the groundwork for future generations to communicate and collaborate more effectively, ultimately shaping a better Kosovo."

A Brighter, More Inclusive Kosovo

In conclusion, the MostUra Festival stands as a powerful testament to the potential for unity and understanding among Kosovo's youth. It demonstrated that by shedding prejudices and embracing diversity, the youth can build a brighter and more harmonious future for themselves and generations to come. MostUra's inaugural edition has left an indelible mark, lighting the way toward a more inclusive and peaceful Kosovo.

NGJYRAT E VJESHTËS 2023



Vjeshta tashmë ka ardhur. Ditët janë më të shkurtra, temperaturat jashtë janë më të ulëta, natyra është shndërruar në një spektakël të bukur ngjyrash dhe e njëjta gjë po ndodh edhe me trendet e modës. Çdo stinë i sjellë me vete ngjyrat karakteristike që na frymëzojnë, ndaj edhe vjeshta ndikon si në natyrë ashtu edhe në modë, duke sjellë me vete një gamë të freskët ngjyrash dhe sfidave të stilit. Ngjyrat e vjeshtës janë shumë më tepër se nuanca të zakonshme. Ato janë një reflektim i natyrës në ndryshim, por edhe një mundësi për ta përshtatur stilin tuaj me mjedisin e ri.

Në vazhdim të tekstit, lexoni për shumëllojshmërinë e ngjyrave të vjeshtës, për tonet e ngrohta të dheut si e kuqja e errët, e verdha okër dhe kafe terrakote që sjellin ngrohtësi dhe rehati gjatë ditëve më të ftohta, si dhe për nuanca më të ftohta si e hirta dhe e gjelbër ulliri, që e sjellin një ndjenjë paqeje dhe serioziteti. Pavarësisht nëse preferoni nuanca

të ngrohta apo të ftohta, vjeshta ofron shumë mundësi për të eksperimentuar me ngjyrat dhe për të krijuar veshje autentike.

E kuqja e mbyllët

Kjo nuanca të kujton ngjyrën e verës dhe boronicës, e cila e krijon një ndjenjë të pasurisë dhe elegancës. Kjo nuanca e përfjetshme shfaqet në çdo stinë

vjeshte. E kuqja e mbyllët përzihet në mënyrë të përkryer me ngjyrat e tjera të vjeshtës, si e kafta, e arta ose e gjelbër ulliri. E kuqja e mbyllët ose burgundi mund të përdoret si një ngjyrë bazë dhe është veçanërisht e popullarizuar për veshjet e mbrëmjes.

E verdha okër

E verdha okër është një nuanca që shpesh mund të shihet në gjethe para se të bien nga pemët. Kjo nuanca e verdhë sjellë gëzim në ditët e vjeshtës me nuancën e saj të ngrohtë dhe me diell. Kjo ngjyrë shpesh kombinohet me ngjyra të errëta për të krijuar kontrast.

E gjelbër ulliri

E gjelbra e ullirit është një nga ngjyrat kryesore të kësaj vjeshte. Me tonin e vetë neutral, ajo i sjellë pak paqe dhe ekuilibër çdo veshjeje. Kjo nuanca është e gjithanshme dhe mund të vishet në mënyra të ndryshme, nga veshjet e lehta të përditshme deri tek kombinimet e sofistikuara të mbrëmjes.

Terrakota kafe

Kafe terrakote është një ngjyrë që përshtatet në mënyrë të përkryer me ngrohtësinë e nuancave të vjeshtës. E veçanta e kësaj nuance të dheut është se i ngjan gjetheve të vjeshtës dhe ia shton autenticitetin çdo pamjeje. Kafe terrakote mund të përdoret si ngjyrë bazë për veshje apo aksesore, si shalle apo çanta.

E kaltër e mbyllët

E kaltra e mbyllët është një nuancë e qetë që lidhet me qiellin e pastër në ditët më të ftohta të vjeshtës. Kjo ngjyrë përzihet me paletat e vjeshtës, duke krijuar një kontrast me ngjyrat më të ngrohta të gjetheve. Përdoret shpesh si ngjyrë bazë për pallto, xhemperë dhe pantallona, por edhe si detaj në kapele, doreza apo çanta. E kaltra e mbyllët është një zgjedhje e shkëlqyer për një pamje të lehtë.

Hiri me nuanca të së kaltrës

Klasike dhe e gjithanshme, ngjyra e hirit përdoret shpesh si bazë neutrale në kombinimet e vjeshtës. Nuancat e së kaltrës i shtojnë thellësi ngjyrës dhe e bëjnë atë më interesante. Ngjyra e hirit me nuancat e së kaltrës e sjellë një dozë serioziteti dhe elegancë, si dhe e krijon mundësinë për kreativitet në të shprehurit e modës. Kjo ngjyrë mund të përdoret në kombinime me shtresa që krijojnë dimension dhe thellësi, duke shtuar teksturë dhe kontraste interesante.

Vjeshta na i kujton ndryshimet dhe na e jep mundësinë që të eksplorojmë diversitetin dhe pasurinë e ngjyrave që na rrethojnë. Me këtë përzgjedhje të ngjyrave të vjeshtës, secili prej nesh mund të krijojë veshje që e pasqyrojnë frymën e stinës por që në të njëjtën kohë e theksojnë individualitetin.

AUTUMN COLORS 2023

Here we are, already well into autumn. Days are shorter, outside temperatures are lower, nature is being transformed into a beautiful spectacle of colors, and the same is happening with fashion trends. Each season brings along characteristic colors that inspire us, and autumn as well impacts nature and fashion, bringing a fresh palette of colors and style challenges. Autumn colors are much more than just hues. They are a reflection of the changing nature, but also an opportunity to adapt your style to the new environment.

Read below about the diversity of autumn colors, about warm earthy tones like burgundy, ochre yellow and terracotta brown that bring warmth and comfort during colder days, as well as about cooler shades like gray and olive-green, which bring a sense of peace and seriousness. Whether you prefer warm or cool shades, autumn offers many opportunities to experiment with colors and create authentic outfits.

Burgundy

This shade is reminiscent of the color of wine and blueberries, creating a feeling of sumptuousness and elegance. This timeless shade appears in every autumn season. Burgundy matches perfectly with other autumn colors, such as brown, gold, or olive-green. Dark red or burgundy can be used as a base color, and is especially popular for evening outfits.

Ochre

Ochre is a shade that can often be seen on leaves before they fall from the trees. This shade of yellow brings cheerfulness to autumn days with its warm and sunny shade. This color is often combined with darker hues to create contrast.

Olive-green

Olive-green is one of the top colors this autumn. With its neutral tone, it adds a touch of peace and balance to any look. This shade is versatile and can be worn in a variety of ways, from lightweight everyday clothes to sophisticated evening combinations.

Terracotta brown

Terracotta brown is a color that fits perfectly with the warmth of autumn tones. What is special

about this earthy tone is that it is reminiscent of autumn leaves and adds authenticity to any look. Terracotta brown can be used as a base color for clothing or accessories, such as scarves or bags.

Navy blue

Navy blue is a calm shade that is associated with clear skies on cooler autumn days. This color blends in with autumn palettes, creating contrast with the warmer colors of the leaves. It is often used as a base color for coats, sweaters and trousers, but also as a detail in hats, gloves or bags. Navy blue is a great choice for a subtle look.

Gray with shades of blue

Classic and versatile, gray is often used as a neutral base in autumn combinations. Shades of blue add depth to the color and make it more interesting. Gray imbued with shades of blue adds a touch of seriousness and elegance and also opens up the possibility for creativity in the fashion expression. This color can be used in layered combinations that create dimension and depth, adding texture and interesting contrasts.

Autumn reminds us of changes and gives us the opportunity to explore the diversity and richness of colors that surround us. With this selection of autumn colors, each of us can create outfits that reflect the spirit of the season while at the same time highlighting individuality.



NOTA HARMONIKE: FESTIVALI INAUGURUES I DITËVE NDËRKOMBËTARE TË XHAZIT NË MITROVICË



Në fund të gushtit dhe fillim të shtatorit të vitit 2023, qyteti magjepsës i Mitrovicës, i shtrirë përgjatë lumit Ibër, ishte mikpritës i një ekstravagance të jashtëzakonshme muzikore - Festivalit inaugurues të Ditëve Ndërkombëtare të Xhazit në Mitrovicë. Ky festival, me një organizim pesëditor të jashtëzakonshëm, jo vetëm që e festoi fuqinë unifikuese të muzikës, por gjithashtu i shpalosi disa nga performancat më magjepsëse që janë parë ndonjëherë.

Rapsodi buzë lumit

Festivali i Ditëve Ndërkombëtare të Xhazit në Mitrovicë u konceptua me një vizion të qartë - për të krijuar një hapësirë harmonike ku muzika i kapërceu kufijtë dhe dallimet. Xhazi, me rrënjët e tij që shtrihen nëpër kontinente, doli të ishte mediumi i përsosur. Përtej muzikës, Festivali inaugurues i Ditëve Ndërkombëtare të Xhazit në Mitrovicë ishte një triumf i bashkimit, duke bashkuar me lehtësi njerëz me prejardhje të ndryshme që e kishin një pasion të përbashkët për muzikën.

Platformë për kultivimin e talenteve

Rona Nishliu, themeluesja vizionare e Festivalit të Ditëve Ndërkombëtare të Xhazit në Mitrovicë, e shprehu mirënjohjen e saj të thellë për mbështetjen dhe pjesëmarrjen e jashtëzakonshme. Ajo i ndau mendimet e saj për ndikimin e festivalit, duke thënë: "Mitrovica ka qenë gjithmonë një burim talentesh dhe këto aktivitete kanë qenë të domosdoshme. Pavarësisht se muzika Xhaz e ka një audiencë të veçantë, ne ishim të kënaqur që pamë jo vetëm entuziastë të Xhazit, por edhe qytetarë që morën pjesë në këtë ngjarje, të shtyrë nga një ndjenjë nostalgjie për Mitrovicën e dikurshme të

mbushur me aktivitete kulturore". Përkushtimi i Rona Nishliut për të kultivuar skenën kulturore në qytet ishte i dukshëm dhe ajo e theksoi rëndësinë e festivalit si një platformë për kultivimin e talenteve dhe pasurimin e peizazhit kulturor vendas.

Harmonitë Ndërkombëtare

Festivali i Ditëve Ndërkombëtare të Xhazit në Mitrovicë e përqafoi thelbin global të Xhazit duke i shfaqur një sërë talentesh ndërkombëtare që i harmonizuan prejardhjet e tyre të ndryshme muzikore në skenën e tij. Në vijim i kemi paraqitur shfaqjet e dalluara që rezonuan me publikun:

Daphna Levy dhe Tamir Miler (Izrael/Taxhikistan)

Daphna Levy, një vokaliste dhe perkusioniste izraelite e Xhazit, së bashku me pianistin taxhikistanez Tamir Miler, e dhanë një performancë magjepsëse që i kapërceu kufijtë kulturorë. Muzika e tyre në mënyrë të rrjedhshme e ndërthuri Xhazin me elementë të ndikimeve ballkanike dhe të Lindjes së Mesme, duke e krijuar kështu një përvojë vërtet magjepsëse. Vokalet përhumbëse të Levy-t, së bashku me aftësitë mjeshtërore të Miler-it në piano, e pikturuan një peizazh

muzikor që e magjepsi audiencën.

Elina Duni dhe Rob Luft Duo (Shqipëri/Mbretëri e Bashkuar)

Elina Duni, një vokaliste e njohur shqiptare, i bashkoi forcat me kitaristin britanik Rob Luft, për të shfaqur bukurinë e melodive shqiptare të shkrirë në Xhaz. Performanca e tyre e çoi publikun në një udhëtim nëpër trashëgiminë e pasur muzikore të Shqipërisë, ndërthurur bukur me frymën improvizuese të Xhazit.

MIJD Big Band (Të ndryshëm)

Bendi i Madh i Ditëve Ndërkombëtare të Xhazit të Mitrovicës (MIJD Big Band), i përbërë nga muzikantë vendas dhe ndërkombëtarë, e solli një tingull të fuqishëm ansambli në festival. Interpretimi i kompozimeve klasike dhe bashkëkohore të Xhazit nga ky grup e vuri në pah gjithëpërfshirjen e Xhazit si një gjuhë uniteti dhe shprehjeje.

Richard Bona (Kamerun/SHBA)

Basisti dhe vokalisti Richard Bona, me origjinë nga Kameruni, por me bazë në SHBA, e zbukuroi skenën e festivalit me Xhazin e tij afro-lat-in. Muzika e tij ishte një dëshmi e misionit të festivalit për të thyer kufijtë dhe për të kremtuar rrënjët e shumëllojshme të Xhazit. Virtuoziteti i Bonës në bas dhe vokali plot shpirt e magjepsën publikun.

Karen Asatryan dhe Andrej Prozorov (Armeni/Ukrainë)

Pianistja armene Karen Asatryan dhe perkusionisti ukrainas Andrej Prozorov e shfaqën mjeshtërinë e tyre të improvizimit të Xhazit. Performanca



Të gjitha fotot nga: Mrinë Godanca



e tyre ishte një bashkim i ndikimeve armene dhe ukrainase, duke e krijuar një bisedë muzikore që i kapërceu barrierat gjuhësore dhe i preku zemrat e publikut.

Një kremtë e jashtëzakonshme e muzikës dhe unitetit

Këto bashkëpunime ndërkombëtare ia dhanë një shtresë pasurie shtesë Festivalit të Ditëve Ndërkombëtare të Xhazit në Mitrovicë. Bashkimi i kulturave dhe traditave muzikore na rikujtoi se muzika xhaz e ka fuqinë që të bashkojë njerëz nga të gjitha fushat. Me të përfunduar edicioni inauguroes i festivalit, ai la gjurmë të pashlyeshme si tek artistët ashtu edhe tek publiku, duke e ndezur kështu pritjen me padurim për edicionin e radhës të kësaj kremte të mrekullueshme të muzikës dhe unitetit.

Si përfundim, Festivali inauguroes i Ditëve Ndërkombëtare të Xhazit në Mitrovicë ishte një sukses kumbues, që e lartësoi fuqinë e muzikës për të bashkuar dhe frymëzuar. Gjatë pesë ditëve të paharrueshme, ai shpalosi performanca të jashtëzakonshme që e ndërthurën shpirtin e xhazit me kulturën ballkanike. Në një qytet që ka parë mjaft ndarje, ky festival e ofroi një vështrim në një të ardhme harmonike ku muzika ishte gjuha universale që i kapërceu ndarjet, duke lënë gjurmë të pashlyeshme në Mitrovicën dhe njerëzit e saj.

HARMONIOUS NOTES:

THE INAUGURAL MITROVICA INTERNATIONAL JAZZ DAYS FESTIVAL

In late August and early September of 2023, the enchanting city of Mitrovica, nestled along the Ibër River, played host to an extraordinary musical extravaganza - the inaugural Mitrovica International Jazz Days Festival. Spanning five extraordinary days, this festival not only celebrated the unifying power of music but also showcased some of the most captivating performances ever witnessed.

A Riverside Rhapsody

The Mitrovica International Jazz Days Festival was conceived with a clear vision - to create a harmonious space where music transcended borders and differences. Jazz, with its roots stretching across continents, proved to be the perfect medium. Beyond the music, the inaugural Mitrovica International Jazz Days Festival was a triumph of togetherness, seamlessly bringing together people of varied backgrounds who shared a common passion for music.

A Platform for Nurturing Talent

Rona Nishliu, the visionary founder of the Mitrovica International Jazz Days Festival, expressed her profound gratitude for the overwhelming support and participation. She shared her thoughts on the festival's impact, saying, "Mitrovica has always been a wellspring of talent, and these activities have been invaluable. Despite the fact that jazz music has a niche audience, we were pleased to see not only jazz enthusiasts but also citizens attending the event, driven by a sense of nostalgia for the Mitrovica of yesteryears filled with cultural activities." Rona Nishliu's dedication to nurturing the cultural scene in the city was evident, and she emphasized the festival's significance as a platform for nurturing talent and enriching the local cultural landscape.

International Harmonies

The Mitrovica International Jazz Days Festival embraced the global essence of jazz by featuring an array of international talents who harmonized their diverse musical backgrounds on its stage. Here are the standout performances that resonated with the audience:

Daphna Levy and Tamir Miler (Israel/Tajikistan):

Daphna Levy, an Israeli jazz vocalist and percussionist, alongside Tajikistani pianist Tamir Miler, delivered a mesmerizing performance that transcended cultural boundaries. Their music seamlessly blended jazz with elements of Balkan and Middle Eastern influences, creating a truly enchanting experience. Levy's haunting vocals, coupled with Miler's masterful piano skills, painted a musical landscape that captivated the audience.

Elina Duni and Rob Luft Duo (Albania/UK):

Elina Duni, a renowned Albanian vocalist, joined forces with British guitarist Rob Luft to showcase the beauty of

Albanian melodies fused with jazz. Their performance took the audience on a journey through the rich musical heritage of Albania, beautifully intertwined with the improvisational spirit of jazz.

MIJD Big Band (Various): The Mitrovica International Jazz Days Big Band, composed of both local and international musicians, brought a powerful ensemble sound to the festival. Their rendition of jazz classics and contemporary compositions highlighted the universality of jazz as a language of unity and expression.

Richard Bona (Cameroon/USA): Bassist and vocalist Richard Bona, originally from Cameroon but based in the USA, graced the festival stage with his Afro-Latin-infused jazz. His music was a testament to the festival's mission of breaking down borders and celebrating the diverse roots of jazz. Bona's virtuosity on the bass and soulful vocals left the audience enchanted.

Karen Asatrian and Andrej Prozorov (Armenia/Ukraine): Armenian pianist Karen Asatrian and Ukrainian percussionist Andrej Prozorov showcased their mastery of jazz improvisation. Their performance was a fusion of Armenian and Ukrainian influences, creating a musical conversation that transcended language barriers and touched the hearts of the audience.

A Remarkable Celebration of Music and Unity

